



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në gjykimin e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, Trupi Gjykses më 14 nëntor miratoi pjesërisht një kërkesë të Prokurorisë që dëshmitë dhe provat shoqëruese të shtatë dëshmitarëve të pranoheshin me shkrim. Dëshmitarët do të jenë në dispozicion për t'u marrë në pyetje nga Mbrojtja në sallë të gjyqit. Trupi Gjykses hodhi poshtë kërkesën në lidhje me disa prova shoqëruese që kanë të bëjnë me një dëshmitar. Megjithatë, Trupi Gjykses theksoi se kjo nuk e pengon Prokurorinë të kërkojë që t'i paraqesë dokumentet nëpërmjet një dëshmitari që jep dëshmi në sallë të gjyqit ose si prova jogojore, që do të thotë pa pasur lidhje me ndonjë dëshmitar.

Këtë javë, tre dëshmitarë dëshmuan në sallë të gjyqit në këtë çështje gjyqësore. Sipas përmbledhjes që dha Prokuroria, dëshmitari Nezir Çoçaj iu bashkua UÇK-së në 1998 dhe më vonë shërbeu në Zonën Operative të Pashtrikut. Ai dha dëshmi kryesisht në seancë publike. Dëshmitari i dytë ishte dëshmitar i mbrojtur, që dha dëshmi nëpërmjet videolidhjes. Sipas përmbledhjes që dha Prokuroria, dëshmitari u rrëmbye nga anëtarë të UÇK-së në 1999 dhe më pas u ndalua dhe keqtrajtua në një vendndalim vendor të UÇK-së. Dëshmitari i tretë filloi dhënien e dëshmisë sot paradite, po ashtu me masa mbrojtëse dhe nëpërmjet videolidhjes. Sipas përmbledhjes që dha Prokuroria, dëshmitari u rrëmbye në 1998 nga persona që mbanin emblemën e UÇK-së dhe më pas u ndalua dhe keqtrajtua në një vendndalim të UÇK-së.

Deri më sot, 106 dëshmitarë kanë dhënë dëshmi në sallë të gjyqit në këtë çështje gjyqësore.

Seanca e ardhshme në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* është caktuar për të hënë, 25 nëntor, në orën 09:00 paradite.

Në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës, Trupi Gjykses do të shpallë Urdhrin për Zhdëmtim të premtën, 29 nëntor në orën 11:00 në seancë publike. Tetë viktimat morën pjesë në këtë proces gjyqësor. Ky është urdhri i dytë për zhdëmtim në gjykim për krime lufte i lëshuar nga një Trup Gjykses i Dhomave të Specializuara.

Më 15 nëntor, Mbrojtja e z. Shala i kërkoi Trupit Gjykses që t'i lejojë z. Shala mosparaqitje në seancë gjyqësore ose të shtyjë datën e shpalljes, sepse po atë ditë, ai ka vizitë të konfirmuar nga gjashtë persona që udhëtojnë nga jashtë shtetit. Mbrojtësi theksoi përkushtimin e z. Shala për t'u paraqitur në seancën e shpalljes së Urdhrit për Zhdëmtim.

Të gjithë të paraburgosurit kanë mundësi të arsyeshme për mbajtjen e marrëdhënieve personale. Përveç vizitave dhe letërkëmbimeve, ata mund të presin 10 vizita në muaj nga të afërm të ngushtë dhe persona me





të cilët kanë marrëdhënie personale prej më herët. Kujdes i veçantë i kushtohet organizimit të vizitave prej familjes në bazë të një procedure të thjeshtuar.

Më 14 nëntor, Kryetarja Ekaterina Trendafilova caktoi Panelin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur mbi kërkesën referuese të Haxhi Shalës drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Dhomave të Specializuara. Kërkesa referuese e z. Shala drejtuar Gjykatës Kushtetuese vjen pas Vendimit mbi Kërkesën e Haxhi Shalës për Mbrojtje të Ligjshmërisë, të Panelit të Gjykatës Supreme, në të cilin hodhi poshtë kërkesën e z. Shala për mbrojtje të ligjshmërisë në lidhje me urdhrin e parë të Gjykatës të Procedurës Paraprake mbi paraburgimin e z. Shala. Paneli i Gjykatës Kushtetuese përbëhet prej gjykatësve Vidar Stensland, Rumen Nenkov dhe Romina Inkuti.

